**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**
**SENATI**

*Nr._57_prot.* *Shkodër, më 06. 01.2022*

**V E N D I M**

Nr. 5 , datë 06. 01 .2022

**"Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë financiare të USH-së për vitin akademik 2020-2021"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 32, 37, 38; Statutit të USH-së neni 17, II, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 06.01.2022,

**Vendosi:**

1. Të miratojë raportin vjetor të veprimtarisë financiare për vitin akademik 2020-2021 në Universitetin e Shkodrës, ''Luigj Gurakuqi''.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**

**Prof. dr. Suzana GOLEMI**

**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**
**REKTORATI**

# RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË SË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

## PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

## (01 Tetor 2020 – 30 Shtator 2021)

## BORDI I ADMINISTRIMIT

a) ***Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.***

1. **Të dhëna të përgjithshme mbi Universitetin e Shkodrës në lidhje me strukturën e përgjithshme organizative, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse (Udhëzimi nr.5 dt. 19.02.2018 paragrafi B, pika a)**

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", gjatë vitit akademik 2020–2021 ka operuar në zbatim të vendimit të Senatit Akademik nr.14 dt.10.01.2020 dhe vendimit të Bordit të Administrimit nr.16 dt.10.01.2020.

"Për detajimin e grantit 2020 (grant i mësimdhënies)", në zbatim të Udhëzimit të MASR nr. 27 datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë"

Universiteti i Shkodrës ka në përbërjen e tij në total 312 punonjës (numri maksimal i arritur gjatë vitit akademik në fjalë). Ky personel është i punësuar në Rektorat, dhe 6 Fakultetet përbërëse të UNISHK-së.

1.1. Rektorati i Universitetit të Shkodrës ka në përbërjen e tij: Rektorin, zv.rektorin dhe administratorin si autoritete drejtuese. Në këtë strukturë punojnë 70 punonjës administrativ të organizuar në drejtori/njësi dhe ku çdo drejtori ka në përbërje sektorë, si më poshtë:

1.1.1. Drejtoria e Kurikulave Kërkimit shkencor dhe Standardeve
- Sektori i kurikulave dhe kërkimit shkencor
- Sektori i sigurimit të cilësisë, këshillimit të karrierës dhe alumni.

1.1.2. Drejtoria e Bibliotekës Shkencore
- Sektori bibliotekare-arkivist
- Sektori i klasifikator-restaurator

1.1.3. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore
- Sektori Juridik
- Sektori i Protokoll Arkivës
- Sektori i Burimeve Njerëzore

1.1.4. Drejtoria e IT-së
- Sektori i menaxhimit të sistemit
- Sektori i zhvillimit dhe mirëmbajtjes IT

1.1.5. Drejtoria Ekonomike
- Sektori i financës dhe buxhetit

1.1.6. Drejtoria e Shërbimeve dhe Prokurimeve
- Sektori i prokurimeve

1.1.7. Laboratori i diagnostikimit Mikrobiologjik

1.1.8. Sektori i Komunikimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve

1.1.9. Auditi i brendshëm

1.2. Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ka në përbërjen e tij 6 (gjashtë) fakultete të ndara në departamente/qendra kërkimore. Struktura organizative ka në përbërje personel akademik,

ndihmësakademik me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ. Fakultetet e Universitetit të Shkodrës janë të organizuar në departamente dhe kanë në përbërje krahas personelit akademik edhe personel ndihmës akademikë/laborantë, të cilët ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies. Pjesë përbërëse e strukturës së Fakultetit janë edhe sekretaritë mësimore. Njësitë bazë të secilit fakultet paraqiten:

1.2.1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës:
- Departamenti i Biologji-Kimisë
- Departamenti i Fizikës
- Departamenti i Matematikë-Informatikë
- Departamenti i Infermierisë
- Qendra e Studimit të Ujrave

1.2.2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore:
- Departamenti i Gjuhës Shqipe
- Departamenti Letërsisë
- Departamenti i Historisë
- Departamenti i Gjeografisë
- Qendra e Studimeve Albanologjike

1.2.3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit:
- Departamenti i Mësuesisë
- Departamenti i Psikologjisë dhe Punes Sociale
- Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve
- Departamenti i Arteve

1.2.4. Fakulteti i Drejtësisë:
- Departamenti i te Drejtës Publike
- Departamenti i të Drejtës Civile
- Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane

1.2.5. Fakulteti Ekonomik:
- Departamenti i Administrim Biznesit
- Departamenti i Financë Kontabilitetit
- Departamenti i Turizmit

1.2.6 Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

- Departamenti i Gjuhës Angleze
- Departamenti i Gjermanistikës
- Departamenti i Romanistikës

1.3. Autoritetet drejtuese të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" janë:
- Rektori
- Administratori
- Drejtues të njësive kryesore – Dekan fakulteti
- Drejtues të njësive bazë: Drejtues departamenti, Drejtues drejtorie.




Fakultetet në vite

Numri i punonjësve në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" për vitin 2020 u parashikua 344 personel akademik dhe joakademik (ndihmës akademikë me karakter mësimor-administrativ dhe personel administrativ).
Për periudhën janar–dhjetor të vitit 2020 kanë punuar 293 punonjës (numri maksimal i periudhës), nga të cilët 63% janë personel akademik dhe 37% janë personel ndihmësakademik dhe administrativ. Për më tepër detaje paraqesim të dhënat si më poshtë:

**Numri i punonjësve Viti 2020**

| Emertimi | Gjithsej | Meshkuj | Femra | % që zënë femrat |
|---|---|---|---|---|
| **Gjithsej** | 293 | 76 | 217 | 74% |
| Drejtues | 51 | 18 | 33 | 65% |
| Specialistë | 220 | 54 | 166 | 75% |
| Teknik i mesëm | 4 | 4 | - | 0% |
| Punëtorë | 18 | - | 18 | 100% |

Për periudhën janar–shtator të vitit 2021 kanë punuar 312 punonjës (numri maksimal i periudhës) nga të cilët 63% personel akademik dhe 37% personel ndihmësakademikë me karakter administrativ dhe punonjës administrativë. Paraqiten të dhëna si më poshtë:

**Numri i punonjësve Viti 2021**

| Emertimi | Gjithsej | Meshkuj | Femra | % që zënë femrat |
|---|---|---|---|---|
| **Gjithsej** | 312 | 79 | 233 | 75% |
| Drejtues | 52 | 18 | 34 | 65% |
| Specialistë | 238 | 57 | 181 | 76% |
| Teknik i mesëm | 4 | 4 | - | 0% |
| Punëtorë | 18 | - | 18 | 100% |

**Për vitin akademik 2020 –2021** për periudhën janar–shtator 2021 nga personeli akademik 71 % janë me gradën Doktor ose titujt Profesor dhe Profesor i Asociuar, ndërsa 29 % me master.






**Të dhëna të përgjithshme mbi: Ciklet e studimit, numri i studentëve, ngarkesa mësimore, shtrirja dhe mjediset**

- **Ciklet e studimit, numri i studentëve.**

- **Ciklet e studimit**

Universiteti i Shkodrës për vitin akademik 2020–2021 kishte këto nivele e programe studimi me kohë të plotë:

- Cikli i parë i studimeve me 27 programe studimi.
- Cikli i dytë i studimeve me 36 programe studimi:
  - Master profesional me 20 programe studimi,
  - Master i shkencave me 16 programe studimi.
  - 2 Programe Profesionale studimi

| Programe studimi në vitet 2017 - 2022 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emërtimi | Vitet | | | | |
| | | 2017 - 2018 | 2018 - 2019 | 2019 - 2020 | 2020 - 2021 | 2021 - 2022 |
| 1 | Bachelor | *26* | *26* | *26* | *27* | *28* |
| 2 | Program Profesional | *0* | *0* | *0* | *2* | *2* |
| 4 | Master Profesional | *19* | *20* | *20* | *20* | *21* |
| 6 | Master Shkencor | *16* | *16* | *16* | *16* | *16* |
| | | *61* | *62* | *62* | *65* | *67* |




- **Numri i studentëve**

Në Universitetin e Shkodrës për vitin akademik 2020–2021 kanë studiuar në të gjithë nivelet e studimeve **3,937** studentë:

- ◊ Në Ciklin e parë të studimit Bachelor kanë studiuar **2,764** studentë.
- ◊ Në Programet profesionale kanë studiuar 39 studentë.
- ◊ Në Ciklin e dytë të studimit kanë studiuar **1,134** studentë nga të cilët:
    - Master profesional kanë studiuar **720** studentë,
    - Master i shkencave kanë studiuar **414** studentë

### *Studentët sipas ndryshimeve në sistemet dhe ciklet e shkollimit*

| *Nr.* | *Sistemi i shkollimit* | *vitet* | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | *2017-2018* | *2018-2019* | *2019-2020* | *2020-2021* |
| A | Cikli i parë | 5,385 | 3,759 | 3,022 | 2,803 |
| - | Bachelor | 5,385 | 3,759 | 3,022 | 2,764 |
| - | Profesionale | - | - | - | 39 |
| B | Cikli i dytë | 1,228 | 1,265 | 1,237 | 1,134 |
| 1 | MP | 824 | 907 | 839 | 720 |
| 2 | MSH | 404 | 358 | 398 | 414 |
| | **Totali** | **6,613** | **5,024** | **4,259** | **3,937** |




## Ngarkesa mësimore

Në vitin akademik 2020–2021 janë realizuar 82,999 orë mësimore mbi të cilat llogaritet pagesa e tyre, sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL". Me rritjen e ngarkesës mësimore në të ardhmen, orët e pambuluara nga personeli efektiv, nga 48,968 bëhen 60,584. Pra, parashikohet rritje e ngarkesës së mësimdhënësve.

## NUMRI I STUDENTEVE DHE NGARKESA MËSIMORE - REALIZIMI - "VITI 2020 - 2021"

| Nr | FAKULTETI | Nr. Student të kohës normale | Nr. P/Akademik | | | Mësimdhënie e pagueshme | | | | Orë mësimore gjithsej | | | Mbulimi me personel akademik | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | E normuar | | Jashtë audit. Brend | Gjithsej | | | | Të brendshëm | | | Norma Jashtëm | Pagesa | | |
| | | | Brend. | Jasht. | Gjithsej | Brend. | Jasht. | | | Brend. | Jasht. | Gjithsej | Norma | Mbi norma Jash. Au | Limiti | | Brend. | Jasht. | Shuma |
| 1 | FSHN | 1,013 | 45 | 28 | 73 | 14,418 | 3,360 | 0 | 17,778 | 14,418 | 6,572 | 20,990 | 6,535 | 7,883 | 13,500 | 3,360 | 7,883 | 3,360 | 11,243 |
| 2 | FSHSH | 324 | 36 | 6 | 42 | 10,613 | 720 | 0 | 11,333 | 10,613 | 987 | 11,600 | 4,752 | 5,861 | 10,800 | 720 | 5,861 | 720 | 6,581 |
| 3 | FSHE | 897 | 38 | 39 | 77 | 11,960 | 4,680 | 400 | 17,040 | 12,360 | 5,930 | 18,290 | 6,119 | 6,241 | 11,400 | 4,680 | 6,241 | 4,680 | 10,921 |
| 4 | FE | 914 | 30 | 23 | 53 | 11,061 | 2,760 | 0 | 13,821 | 11,061 | 4,059 | 15,120 | 4,495 | 6,566 | 9,000 | 2,760 | 6,566 | 2,760 | 9,326 |
| 5 | FGJH | 298 | 25 | 19 | 44 | 8,793 | 2,280 | 0 | 11,073 | 8,793 | 3,253 | 12,046 | 3,660 | 5,133 | 7,500 | 2,280 | 5,133 | 2,280 | 7,413 |
| 6 | FD | 491 | 21 | 7 | 28 | 4,484 | 840 | 0 | 5,324 | 4,484 | 469 | 4,953 | 1,840 | 2,644 | 6,300 | 840 | 2,644 | 840 | 3,484 |
| | TOTALI | 3,937 | 195 | 122 | 317 | 61,329 | 14,640 | 400 | 76,369 | 61,729 | 21,270 | 82,999 | 27,401 | 34,328 | 58,500 | 14,640 | 34,328 | 14,640 | 48,968 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Norma mesatare e ngarkesës | 141 orë mësimore | | Orë të pa mbuluara nga personeli efektiv | 48,968 orë mësimore |
| Norma e ngarkesës të jashtëm | 120 orë mësimore | | Orë të pagueshme nga personeli efektiv | 34,728 orë mësimore |
| % që mbulon stafi efektiv mbi normë | 124 % | | Numri i personelit efektiv | 436 Punonjës |
| % që mbulon stafi efektiv gjithsej | 80 % | | Numri i personelit jo efektiv | 122 Punonjës |
| % që mbulon stafi jashtëm | 19 % | | Numri i personelit gjithsej | 558 Punonjës |
| | | | Numri i punonjësve efektiv gjithsej (normën mesatare) | 543 Punonjës |

## NUMRI I STUDENTEVE DHE NGARKESA MËSIMORE - PARASHIKIMI - "VITI 2021 - 2022"

| Nr | FAKULTETI | Nr. Student të kohës normale | Nr. P/Akademik | | | Mësimdhënie e pagueshme | | | | Orë mësimore gjithsej | | | Mbulimi me personel akademik | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | E normuar | | Jashtë audit. Brend | Gjithsej | | | | Të brendshëm | | | Norma Jashtëm | Për Pagesë | | |
| | | | Brend. | Jasht. | Gjithsej | Brend. | Jasht. | | | Brend. | Jasht. | Gjithsej | Norma | Mbi norma Jash. Au | Limiti | | Brend. | Jasht. | Shuma |
| 1 | FSHN | 1,140 | 54 | 129 | 183 | 11,649 | 8,358 | 0 | 20,007 | 16,226 | 8,358 | 24,583 | 7,842 | 3,807 | 16,200 | 15,480 | 3,807 | 8,358 | 12,165 |
| 2 | FSHSH | 380 | 43 | 17 | 60 | 6,068 | 7,224 | 0 | 13,292 | 12,447 | 7,224 | 19,671 | 5,676 | 392 | 12,900 | 2,040 | 392 | 7,224 | 7,616 |
| 3 | FSHE | 1,061 | 47 | 49 | 96 | 13,736 | 5,947 | 585 | 20,268 | 14,620 | 5,947 | 20,567 | 7,568 | 6,753 | 14,100 | 5,880 | 6,753 | 5,947 | 12,700 |
| 4 | FE | 1,056 | 35 | 47 | 82 | 10,712 | 5,256 | 0 | 15,968 | 12,779 | 5,256 | 18,035 | 5,244 | 5,468 | 10,500 | 5,640 | 5,468 | 5,256 | 10,724 |
| 5 | FGJH | 467 | 28 | 36 | 64 | 13,052 | 4,301 | 0 | 17,353 | 13,780 | 4,301 | 18,080 | 4,099 | 8,953 | 8,400 | 4,320 | 8,400 | 4,301 | 12,701 |
| 6 | FD | 572 | 23 | 11 | 34 | 2,547 | 3,655 | 0 | 6,202 | 5,224 | 3,655 | 8,879 | 2,015 | 532 | 6,900 | 1,320 | 532 | 3,655 | 4,187 |
| | TOTALI | 4,676 | 230 | 289 | 519 | 57,764 | 34,740 | 585 | 93,090 | 75,076 | 34,740 | 109,816 | 32,445 | 25,904 | 69,000 | 34,680 | 25,352 | 34,740 | 60,092 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Norma mesatare e ngarkesës efektiv | 141 orë mësimore | | Orë të pa mbuluara nga personeli efektiv | 60,584 orë mësimore |
| Norma e ngarkesës të jashtëm | 120 orë mësimore | | Orë të pagueshme nga personeli efektiv | 26,490 orë mësimore |
| % që mbulon stafi efektiv mbi normë | 78 % | | Numri i personelit efektiv | 409 Punonjës |
| % që mbulon stafi efektiv gjithsej | 63 % | | Numri i personelit jo efektiv | 290 Punonjes |
| % që mbulon stafi jashtëm | 37 % | | Numri i personelit gjithsej | 699 Punonjës |
| | | | Numri i punonjësve efektiv gjithsej (normën mesatare) | 660 Punonjës |

***b) Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit. (Udhëzimi nr. 5, dt 19.02.2018, paragrafi B, pika b)***

**1. Projekt Buxheti afatmesëm vitet 2022-2024**

Hartimi i projektbuxhetit të vitit 2022 është bazuar në projektet e paraqitura deri në momentin e hartimit të tij, në ecurinë e realizimit të pritshëm të buxhetit për vitin 2021 dhe në ndryshimet në: strukturën organizative dhe numrin e punonjësve, programet e studimit, numrit të studentëve të pritshëm, në nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit.
Nga strukturat bazë të Universitetit janë paraqitur kërkesa për projektet afatmesme 2022 – 2024, si për procesin e veprimtarisë kryesore të këtyre njësive edhe për atë kërkimore e shkencore, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Strategjinë e Universitetit "Luigj Gurakuqi".
Financimi i projektbuxhetit për vitet 2022 – 2024 paraqitet si më poshtë:

**Granti ( Fonde të pakushtëzuara) për vitin 2022 - 2024**

| Nr | Emërtimi i projektit | 2022 000/lekë | 2023 000/lekë | 2024 000/lekë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Grante për shpenzime korente dhe Transferta | *541,770* | *556,429* | *571,348* |
| 2 | Grante për investime | *140,194* | *125,232* | *99,537* |
| 3 | Kërkim shkencor | *27,350* | *0* | *0* |
| 4 | TVSH-projekte të huaja | *0* | *0* | *0* |
| | **TOTALI** | ***709,313*** | ***681,661*** | ***670,885*** |

**Të ardhura të institucionit për vitin 2022 - 2024**

| Nr | Emërtimi i projektit | 2022 000/lekë | 2023 000/lekë | 2024 000/lekë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Fondet nga të ardhurat për shpenzime korrente | *100,549* | *102,929* | *105,366* |
| 2 | Fonde nga të ardhurat për investime | *82,535* | *43,702* | *17,500* |
| | **TOTALI** | ***183,084*** | ***146,631*** | ***122,866*** |

Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit të Universitetit përbën PBA – në e viteve 2022-2024.
Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh. shpenzimet për rojet private, shpenzimet për internetin, si dhe shpenzime për mirëmbajtje. Vënia në punë e ngrohjes qendrore në tërë godinat do të paraqesë nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Ndarja për çdo artikull është

llogaritur duke u nisur nga fakti i artikujve të vitit të kaluar, nga realizimi i pritshëm i këti viti, si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.

*(000/Lekë)*

**Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) VITI 2022- 2024**

| *Artikulli* | *Emertimi* | *Fakti i vitit 2020* | | *I Pritshmi i vitit 2021* | | *Parashikimi për vitin 2022* | | | *2023* | *2024* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Grant* | *Nga të ardhurat* | *Grant* | *Nga të ardhurat* | *Limiti* | *Kërkesa* | *Nga të ardhurat* | *Kërkesa* | *Kërkesa* |
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* | *6* | *7* | *8* | *9* | *10* | *11* |
| **602.0** | **Materiale zyre dhe të përgjithshme** | 1,424 | 0 | 5,599 | 239 | 7,260 | 0 | 7,260 | 7,478 | 7,702 |
| **602.1** | **Materiale dhe shërbime speciale** | 1,507 | 0 | 2,160 | 650 | 4,360 | 0 | 4,360 | 4,491 | 4,626 |
| **602.2** | **Shërbime nga të tretë** | 31,531 | 8,022 | 37,289 | 10,625 | 48,040 | 31,270 | 16,770 | 49,481 | 50,783 |
| **602.3** | **Shpenzime transporti** | 141 | 0 | 240 | 0 | 480 | 0 | 480 | 494 | 509 |
| **602.4** | **Shpenzime udhëtimi** | 7 | 0 | 0 | 6,200 | 8,285 | 2,085 | 6,200 | 8,534 | 8,790 |
| **602.5** | **Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme** | 1,048 | 0 | 18,804 | 0 | 8,520 | 0 | 8,520 | 8,776 | 9,039 |
| **602.9** | **Shpenzime të tjera operative** | 2,483 | 10,251 | 800 | 19,960 | 11,480 | 9,000 | 2,480 | 11,824 | 12,179 |
| | **Totali** | **38,140** | **18,272** | **64,892** | **37,674** | **88,425** | **42,355** | **46,070** | **91,078** | **93,628** |

***c) Realizimi faktik i planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planit buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.***

### 1. Realizimi i buxhetit viti 2020

Fillimisht sqarojmë që fillimi i vitit 2020 ishte edhe fillimi i pandemisë mbarëbotërore COVID-19.

Buxheti për vitin 2020 është dërguar nga Administratorja për organet kolegjale me nr. 896 Prot. dt 28.02.2021 në muajin shkurt por miratimi i tij në organet kolegjale është bëre si vijon si rezultat i kufizimeve të pandemisë globale COVID-19:

-Është miratuar buxheti i vitit 2020 (plani i shpenzimeve korrente) me vendimin e Bordit të Administrimit nr. 241, dt 28.08.2020.

-Është miratuar buxheti i vitit 2020 (plani i investimeve) me vendimin e Bordit të Administrimit nr. 324, dt 15.10.2020.

Nisur nga përcaktimet e VKM nr 243, dt 24.0.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore" ku kërkohej edhe disiplinimi i shpenzimeve.

Për vitin 2020 buxheti i akorduar është në vlerën **683,861,625** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

- Granti i mësimdhënies **538,544,178** lekë.
- Projekte të huaja **3,765,925** lekë,
- Të ardhura të institucionit **141,551,522** lekë,

### 1.1. Hyrjet e fondeve

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2020 të ndara sipas financimeve kanë qenë:
Projektet e huaja: financimi i tyre është realizuar në vlerën 3,765,925 lekë.
Grant mësimdhënie: financimi i tij është realizuar 100 % në vlerën 538,544,178 lekë.
Fondet të kushtëzuar – të ardhurat e Universitetit të Shkodrës: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 141,551,522 lekë.

| *Nr* | Emërtimi | *Fakt* |
|---|---|---|
| **A** | **Të ardhura të vitit** | **141,551,522** |
| *1* | *Qira* | *431,832* |
| *2* | *Tarifa shkollimi* | *123,522,974* |
| *3* | *Taksë regjistrimi* | *3,358,401* |
| *4* | *Tarifa konkurrimi* | *590,000* |
| *5* | *Shërbime të ndryshme* | *9,263,515* |
| *6* | *Analiza laboratorike* | *1,059,800* |
| *7* | *Tjera* | *3,175,000* |
| *8* | *Sponsorizime* | *150,000* |

Plani i grumbullimit të të ardhurave dhe fakti i realizimit të tyre për vitin 2020 u bazua në:

- programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor),
- programet e studimit të ciklit të dytë (MP e MSH),
- numrin e studentëve për çdo program studimi,
- nivelin e tarifave të vendosura me Vendim të Bordit të Administrimit për çdo program studimi, sipas tavaneve të vendosura me VKM-t për çdo rast.

Realizimi i këtij plani është si rezultat:

- Grumbullimi i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2021 në tetor – dhjetor 2020. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2020. Pjesa e papërdorur kanë kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2021.




Në zërat e të ardhurave të grumbulluara, peshën kryesore e zënë:

- Nga totali i të ardhurave rreth 87.3 % vijnë nga tarifa e shkollimit. Grumbullimi i të ardhurave është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria ekonomike dhe fakultetet. Këto të ardhura përbëhen nga:
    - tarifa e shkollimit e programit të ciklit të parë, Bachelor
    - tarifa e shkollimit e programeve profesionale 2 vjeçare
    - tarifa e shkollimit e Ciklit të dytë të studimeve, Master

- Taksë regjistrimi me rreth 2.4 %, ndaj totalit
- Tarifë konkurrimi me rreth 0.4 %, ndaj totalit
- Shërbime të ndryshme ndaj studentëve dhe të tretë-ve rreth 6.5%, ndaj totalit
- Qira mjedise me rreth 0.3 %, ndaj totalit

Në realizimin e të ardhurave kanë ndikuar edhe efekte në ulje:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit, në zbatim të VKM-së dhe Vendimit të BA-së për përjashtim nga pagesa e tarifës së shkollimit të studentëve të Ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe programe profesionale dy vjeçare dhe ulje tarife vjetore e shkollimit . Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë përgjysmim të tarifës së shkollimit në të dyja nivelet.




Siç paraqitet në grafik këto të ardhura janë përdorur:

- për investime 47.9 %,
- për honorare projektesh 13.0 %,
- për shërbime nga të tretët 22.9 %
- për taksa e tarifa 16.2 %

Honoraret e projekteve janë honorare të projekteve SAFE HARBOR dhe FOST INNO ku për projektin SAFE HARBOR është bërë rimbursimi i shumës në vitin 2021, ndërsa fondet e FOST INNO kanë ardhur në periudhat e mëparshme.

### 1.2. Shpenzimet

Gjatë vitit 2020 shpenzimet gjithsej janë realizuar 74.% e planifikimit vjetor.

- Sipas formave të financimit
  - Shpenzimet nga Granti mësimdhënies është realizuar 76.5%.
  - Shpenzimet nga të ardhurat e institucionit janë realizuar 52.7 %.
- Sipas zërave të shpenzimit:
  - Shpenzimet për Paga e shpërblime 78.3 %
  - Shpenzimet për Sigurime shoqërore 82.3 %
  - Shpenzimet për Shpenzime operative 54.8 %
  - Bursat për studentët 70.9 %
  - Shpenzimet për Investimet 69.6 %

➢ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Pagat për vitin 2020 janë mbuluar me fondet nga Granti për mësimdhënie. Planifikimi ka qenë në vlerën 438,072,328. Nga totali i shpenzimeve të realizuara prej 343,054,390 lekë ose 84.4% e grantit të planifikuar, për orë suplementare janë shpenzuar 25,833,896 lekë.

- **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore, si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është realizuar në masën 82.3 % për fondin e planifikuar nga granti. Nga ky fond është përballuar edhe fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore i llogaritur për pagesat e kryera për pedagogët e jashtëm.

- **Shpenzime operative – Artikulli 602**

Shpenzimet operative për vitin 2020 janë përballuar nga të ardhurat dhe Granti për mësimdhënie dhe janë realizuar në masën prej 54.8 %.

- Shpenzimet operative nga Granti për mësimdhënie prej 63.0 %
- Shpenzimet operative nga të ardhurat e institucionit 43.1 %

Shpenzimet operative për vitin 2020, janë realizuar kryesisht për:

- shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë së godinave,
- taksa dhe tarifa të paguara nga institucioni,
- shërbime utilitare, energji elektrike, ujë
- shërbime për ngrohje
- materiale dezinfektimi dhe mbrojtëse ndaj COVID 19
- materiale pastrimi

Në mosrealizimin e këtyre shpenzimeve ka ndikuar kryesisht situata e pandemisë COVID 19, me konkretisht, disa detaje:

-Zëri shpenzime për taksa dhe tarifa të paguara nga institucioni ka një realizim prej 37.7% ose 7,342,431 lekë ku vlera e parealizuar është 12,157,569 lekë. Kjo ka ndodhur për faktin se nuk është vijuar me procesin e akreditimit, për të cilin paguhen tarifat përkatëse.
-Zëri shpenzime udhëtimi dhe dieta është parashikuar në masën 7,700,000 lekë ku është realizuar vetem 6,500 lekë. Kjo si rezutat i situtës së pandemisë COVID 19 pasi nuk është lejuar realizimi i praktikave mësimore.
-Zëri i shpenzimeve për kërkimin shkencor, me vlerë 6,000,000 lekë, është i parealizuar deri në plotësimin e raportit nga grupi i punës.
-Shpenzime energji elektrike dhe ujë nga totali i planifikuar prej 11,877,000 lekë janë realizuar 6,489,027 lekë, ku vlera e parealizuar është 5,387,973 lekë.
-Zëri shpenzime për kërkimin shkencor i planifikuar në vlerën 6,000,000 lekë do të realizohet me paraqitjen e raportit nga grupi i punës.
-Zëri i shpenzimeve operative "Shërbime te sigurimit dhe ruajtjes" për vitin 2020 zë 48.2 % të shpenzimeve operative gjithsej, kjo për faktin se sipas VKM- së për këtë qëllim paga e punonjësve të sigurisë llogaritet me 1.5 herë të pagës minimale në shkallë vendi (nga 26,000 lek/ muaj në 39,000 lek/ muaj). Mbi këtë pagë llogaritet edhe kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore që paguan punëdhënësi.

- Në lidhje me realizimin 20% të llogarisë 6020, diktuar nga situata e sipërcituar, ka qenë e mundur të realizohet vetëm blerja e materialeve të domosdoshme për pastrim dhe dezinfektim. Vlera e parashikuar ka qenë 2,000,000 lekë por vlera e kontratës ka qenë në nivelin 1,423,632 lekë. Kemi të bëjmë me ulje të fondit limit dhe jo mosrealizim të buxhetit. Kjo për faktin se shpenzimet e nevojshme kanë qenë në nivel më të ulët se buxheti si rezultat i çmimit më të ulët se preventivi.

-Në lidhje me tejkalimin 42% të llogarisë 6029005: Në Dhjetor 2020 është bërë pagesa e honorareve të stafit të përfshirë në projektin FOST INNO në vlerën 4,110,463 lekë. Fondi për këto honorare ka ardhur nga donatori në llogarine e Thesarit të Universitetit. Pra, të ardhurat nga janë marrë fondet për honoraret nuk janë të ardhura të gjeneruara nga veprimtaria e Universitetit,mbi të cilat bëhet edhe buxheti, por të ardhura nga projekti. Të ardhurat nga projekti vijnë me destinacion që Universiteti nuk mundet ta ndryshojë.

Në lidhje me realizimin 70% të llogarisë 6022005: Blerja e Gazoil është bërë në periudhën para fillimit të pandemisë kur nuk parashikohej mbyllja si rezultat i kësaj të fundit. Është hedhur në kaldaja e gjithë sasia e blerë.

Në lidhje me tejkalimin 42% të llogarisë 6029005: Në Dhjetor 2020 është bërë pagesa e honorareve të stafit të përfshirë në projektin FOST INNO në vlerën 4,110,463 lekë. Fondi për këto honorare ka ardhur nga donatori në llogarine e Thesarit të Universitetit. Pra, të ardhurat nga janë marrë fondet për honoraret nuk janë të ardhura të gjeneruara nga veprimtaria e Universitetit,mbi të cilat bëhet edhe buxheti, por të ardhura nga projekti. Të ardhurat nga projekti vijnë me destinacion që Universiteti nuk mundet ta ndryshojë.

Kurse llogaria 6029007 është planifikuar për kërkimin shkencor por ka 0% realizim.

| *Artikulli* | *Emërtimi* | *Parashikimi Total* | *Parashikimi Grant* | *Parashikimi të ardhura* | **Realizimi me grant** | **Realizimi me të ardhura** | **Realizimi total** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | 2 | *3* | *4* | *5* | 6 | 7 | 8 |
| | **<<Emërtimi i Programit>>** | | | | | | |
| **602.0** | **Materiale zyre dhe të përgjithshme** | **7,226,600** | **7,226,600** | **0** | **1,423,632** | **0** | **1,423,632** |
| 6020100 | Kancelari | 3.000.000 | 3.000.000 | | 0 | 0 | 0 |
| 6020200 | Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim | 2.000.000 | 2.000.000 | | 1.423.632 | 0 | 1.423.632 |
| 6020300 | Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës | 466.600 | 466.600 | | 0 | 0 | 0 |
| 6020400 | Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale | 100.000 | 100.000 | | 0 | 0 | 0 |
| 6020500 | Blerje dokumentacioni | 700.000 | 700.000 | | 0 | 0 | 0 |
| 6020900 | Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme | 960.000 | 960.000 | | 0 | 0 | 0 |
| **602.1** | **Materiale dhe shërbime speciale** | **2,680,000** | **2,680,000** | **0** | **1,506,802** | **0** | **1,506,802** |
| 6021001 | Uniforma dhe veshje të tjera speciale | 100.000 | 100,000 | | 0 | | 0 |
| 6021002 | Plehra kimike, furnitura veterinare, farëra, fidane e të tjera produkte agrokulturore | 100.000 | 100.000 | | 0 | | 0 |
| 6021003 | Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore | 120.000 | 120,000 | | 100.000 | 0 | 100.000 |
| 6021007 | Libra dhe publikime profesionale | 200.000 | 200.000 | | 93.332 | 0 | 93.332 |
| 6021009 | publik | 960.000 | 960.000 | | 790.800 | 0 | 790.800 |
| 6021010 | Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik | 120.000 | 120,000 | | 344.437 | 0 | 344.437 |
| 6021011 | Softe informatike me karakter të përgjithshëm | 960.000 | 960.000 | | 0 | | 0 |
| 6021099 | Të tjera materiale dhe shërbime speciale | 120.000 | 120.000 | | 178.233 | | 178.233 |
| **602.2** | **Shërbime nga të tretë** | **49,080,251** | **38,234,693** | **10,845,558** | **31,531,005** | **8,021,682** | **39,552,687** |
| 6022001 | Elektricitet | 8.000.000 | 8.000.000 | | 5.321.151 | 0 | 5.321.151 |
| 6022002 | Ujë | 3.877.000 | 3.877.000 | | 1.167.876 | 0 | 1.167.876 |
| 6022003 | Shërbime telefonike | | 0 | | 254.949 | 0 | 254.949 |
| | Internet | 500.000 | 500.000 | | | | |
| 0 | Telefoni Celulare | 400.000 | 400.000 | | 254.949 | 0 | 254.949 |
| 6022004 | Posta dhe shërbimi korrier | 200.000 | 200.000 | | 48.145 | 0 | 48.145 |
| 6022005 | Blerje Gasoil | 7.500.000 | 4.739.409 | 2.760.591 | 5.260.949 | 0 | 5.260.949 |
| 6022008 | Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes | 27.337.131 | 19.438.284 | 7.898.847 | 19.329.255 | 7.835.562 | 27.164.817 |
| 6022009 | Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit | 960.000 | 960.000 | | 0 | | 0 |
| 6022010 | Shërbime të printimit dhe publikimit | 186.120 | | 186.120 | 34.680 | 186.120.0 | 220.800 |
| 6022099 | Shërbime të tjera | 120.000 | 120,000 | | 114.000 | | 114.000 |
| **602.3** | **Shpenzime transporti** | **360,000** | **360,000** | **0** | **140,812** | **0** | **140,812** |
| 6023200 | Pjesë kembimi, goma dhe bateri | 120.000 | 120,000 | | 0 | | 0 |
| 6023300 | Shpenzimet e siguracionit të mjeteve te transportit | 120.000 | 120.000 | | 20.812 | 0 | 20.812 |
| 6023900 | Shpenzime të tjera transporti | 120.000 | 120.000 | | 120.000 | 0 | 120.000 |
| **602.4** | **Shpenzime udhëtimi** | **7,700,000** | **604,140** | **7,095,860** | **6,500** | **0** | **6,500** |
| 6024100 | Udhëtim i brendshëm e dieta | 5.200.000 | 604.140 | 4.595.860 | 6.500 | 0 | 6.500 |
| 6024200 | Udhëtim jashtë shtetit+ceepus | 2.500.000 | 0 | 2.500.000 | 0 | 0 | 0 |
| **602.5** | **Shpenzime për mirembajtje të zakonshme** | **6,698,366** | **6,698,366** | **0** | **1,048,053** | **0** | **1,048,053** |
| 6025100 | Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike | 520.000 | 520.000 | | 0 | 0 | 0 |
| 6025300 | ndërtimore. | 5.018.366 | 5.018.366 | | 576.000 | 0 | 576.000 |
| 6025500 | Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punes+ashensor + fikëse zjarri | 960.000 | 960.000 | | 298.653 | 0 | 298.653 |
| 6025600 | transportit | 200.000 | 200,000 | | 173.400 | 0 | 173.400 |
| **602.9** | **Shpenzime të tjera operative** | **29,195,210** | **4,777,998** | **24,417,212** | **2,482,709** | **10,250,677** | **12,733,386** |
| 6029001 | Shpenzime për pritje e percjellje | 960.000 | 960.000 | | 0 | 0 | 0 |
| 6029002 | Shpenzime për aktivitete sociale për personelin | 480.000 | 480.000 | | 0 | 0 | 0 |
| 6029003 | Shpenzime gjyqësore | 100.000 | 100.000 | | 0 | 0 | 0 |
| 6029004 | Shpenzime për sigurimin e ndërtesave dhe të tjera kosto sigurimi të ngjashme | 700.000 | 700.000 | | 580.000 | 0 | 580.000 |
| 6029005 | Shpenzime për honorare | 1.455.210 | | 1.455.210 | 246.335 | 4.564.620.0 | 4.810.955 |
| 6029007 | Shpenzime për pjesmarrje në konferenca (kërkim shkencor) | 6.000.000 | | 6.000.000 | 0 | 0 | 0 |
| 6029008 | Shpenzime për tatime & taksa të paguara nga institucioni (tarifë akreditimi+taksë matrikullimi) | 19.500.000 | 2.537.998 | 16.962.002 | 1.656.374 | 5.686.057 | 7.342.431 |
| | **Totali** | **102,940,427** | **60,581,797** | **42,358,630** | **38,139,513** | **18,272,359** | **56,411,872** |

- **Bursat e studentëve – Artikulli 606**

Bursat e studentëve janë realizuar në masën 71%. Planifikimi në nivelin 56,202,850 lekë dhe realizimi në nivelin 39,861,584 lekë. Kjo për vitin buxhetor 2020.
Për vitin akademik 2019 – 2020, këto fonde ndahen:

Gjatë vitit akademik 2019-2020 kanë përfituar bursa 509 studentë sipas VKM -së nr.903, dt.21.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë (i ndryshuar). Keto bursa janë miratuar me vendimet e BA nr.410, dt.12.12.2019, nr.107, dt.20.02.2020, si dhe me vendimet e këshillave bashkiakë sa i takon studentëve të viteve të para e ndarë në fakultete si më poshte:

Efekti Financiar 32 197 727 lekë

Numri total i studentëve 509

Studentë Ekselence 150
Studentë nga kategoria sociale 359

| Nr. | Fakulteti | Bursa te perfituara |
|---|---|---|
| 1 | Fakulteti Ekonomik | 94 |
| 2 | Fakulteti I Shkencave Shoqerore | 48 |
| 3 | Fakukteti I Shkencave te Natyres | 175 |
| 4 | Fakulteti i Gjuheve te Huaja | 25 |
| 5 | Fakulteti I shkencave te Edukimit | 97 |
| 6 | Fakulteti i Drejtesise | 70 |
| | **Shuma** | **509** |

Numri i studentëve që përfitojnë nga ulja apo reduktimi me 50% i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2019-2020, në zbatim të Vendimit nr. 778, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr.288, datë 21.5.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", i ndryshuar; numrin e studentëve përfitues për çdo njësi, si dhe efektet financiare të parashikuara miratuar me vendimin e BA nr.426 dt.28.12.2019, nr.425 dt.28.12.2019, nr.107 dt.20.02.2020 është 727 studentë. Për një total 15,450,000 lek.
Numri i studentëve që përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit , sipas VKM nr. 778, datë 26.12.2018 i ndryshuar me VKM nr. 40 /2019 "Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr.288, datë 21.5.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të

parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", i ndryshuar, numrin e studentëve përfitues për çdo njësi, si dhe efektet financiare të parashikuara miratuar me vendimin e BA nr.425, dt.28.12.2019, nr.107 dt.20.02.2020 eshte 575 studente, me efekt financiar 10,566,000 lekë
Numri i studentëve që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve,që përfitojnë reduktim me 50%, të të tarifës vjetore të studimit. Studentët , sipas kategorive, sipas Vendimit nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve të miratuar nga institucionet publike të arsimit të lartë miratuar me vendimin e BA nr.426 dt.28.12.2019, nr.107 dt.20.02.2020, është 152 studentë me efekt financiar 4,884,000lek.

**Cikli i parë dhe i dytë me përjashtim e reduktim tarife sipas fakulteteve**

| Fakultetet | Numri i studenteve |
|---|---|
| FSHSH (Bachelor) | 42 |
| Nxënës me mesatare 9-10(Bachelor) | 18 |
| Reduktim tarife Master shkencor dhe profesional | 25 |
| Nxënës me mesatare 9-10 masa 50% | 9 |
| FSHE (Bachelor) | 95 |
| Nxënës me mesatare 9-10(Bachelor) | 17 |
| Reduktim tarife Master shkencor dhe profesional | 25 |
| Nxënës me mesatare 9-10 masa 50% | 11 |
| FE (Bachelor) | 53 |
| Nxënës me mesatare 9-10(Bachelor) | 34 |
| Reduktim tarife Master shkencor dhe profesional | 38 |
| Nxënës me mesatare 9-10 masa 50% | 11 |
| FSHN (Bachelor) | 129 |
| Nxënës me mesatare 9-10(Bachelor) | 62 |
| Reduktim tarife Master shkencor dhe profesional | 19 |
| Nxënës me mesatare 9-10 masa 50% | 8 |
| FGJH (Bachelor) | 24 |
| Nxënës me mesatare 9-10(Bachelor) | 9 |
| Reduktim tarife Master shkencor dhe profesional | 8 |
| Nxënës me mesatare 9-10 masa 50% | 8 |
| FD (Bachelor) | 57 |
| Nxënës me mesatare 9-10(Bachelor) | 18 |
| Reduktim tarife Master shkencor dhe profesional | 4 |
| Nxënës me mesatare 9-10 masa 50% | 3 |
| **TOTALI** | **727** |

## Kthim tarife sipas fakulteteve për vitin shkollor 2019-2020

| | | Nr. Student | | Nr. Student | |
|---|---|---|---|---|---|
| **FE** | **dega** | **Bachelor** | **Shuma** | **MP** | **shuma** |
| | AD-BIZNES | 10 | 100,000 | 1 | 14,000 |
| | Financë | 18 | 190,000 | 0 | 0 |
| | Turizëm | 5 | 60,000 | 0 | 0 |
| | **totali** | **33** | **350,000** | **1** | **14,000** |
| **FGJH** | **dega** | **Bachelor** | **Shuma** | 0 | 0 |
| | Anglisht | 8 | 80,000 | 0 | 0 |
| | Frëngjisht | 9 | 90,000 | 0 | 0 |
| | Gjermanisht | 5 | 50,000 | 0 | 0 |
| | Italisht | 6 | 60,000 | 0 | 0 |
| | **totali** | **28** | **280,000** | **0** | **0** |
| **FSHN** | **dega** | **Bachelor** | **Shuma** | 0 | 0 |
| | Biologji kimi | 9 | 90,000 | 0 | 0 |
| | Fizioterapi | 23 | 240,000 | 0 | 0 |
| | Infermieri | 56 | 560,000 | 0 | 0 |
| | Informatikë | 5 | 50,000 | 0 | 0 |
| | Mami | 52 | 530,000 | 0 | 0 |
| | Matematike | 4 | 40,000 | 0 | 0 |
| | **totali** | **149** | **1510000** | **0** | **0** |
| **FSHE** | **dega** | **Bachelor** | **Shuma** | **MP** | **shuma** |
| | Arsimi fillor | 7 | 70,000 | 0 | 0 |
| | Parashkollor | 7 | 80,000 | 0 | 0 |
| | Edukim fizik | 8 | 90,000 | 0 | 0 |
| | Punë sociale | 11 | 150,000 | 0 | 0 |
| | Pikturë grafi | 1 | 13,500 | 0 | 0 |
| | Psikologji | 4 | 62,500 | 0 | 0 |
| | **totali** | **38** | **466,000** | **0** | **0** |
| **FD** | **dega** | **Bachelor** | **Shuma** | | |
| | Juridik | 14 | 187,500 | 0 | 0 |
| | **totali** | **14** | **187,500** | **0** | **0** |
| **FSHSHS** | **dega** | **Bachelor** | **Shuma** | | |
| | Gazetari | 8 | 80,000 | 0 | 0 |
| | Gjeografi | 6 | 60,000 | 0 | 0 |
| | Gjuhe letersi | 11 | 137,500 | 0 | 0 |
| | Histori | 1 | 20,000 | 0 | 0 |
| | **totali** | **26** | **297,500** | **0** | **0** |
| | **TOTALI** | **288** | **3,091,000** | **1** | **14,000** |
| | | **Totali** | **289** | **Totali** | **3,105,000** |

- **Shpenzime për investime - artikulli 230/231**

  Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e:

  - **Investimeve nga të ardhurat e vetë institucionit** me fond 24,083,135 lekë. Këto investime janë të gjitha pjesë e artikullit 231:
    - **Investimet - Artikulli 231:**

      Në këtë grup përfshihen shpenzimet për investime, si: ndërtime e rikonstruksione objektesh, blerje pajisjesh për auditorë e zyra, blerje pajisjesh laboratorike për laboratorët mësimorë e shkencorë, fondet e librit etj. Projektet e investimeve të financuara paraqiten në tabelën "Investime viti 2020 - të ardhurat e institucionit".

Rikonstruksion objektesh ndërtimore (në rastin konkret Rikonstruksion salla e konferencave Fakulteti i Gjuhëve të Huaja) është realizuar në vlerën 7,812,328 lekë, por është kontratë në vazhdim që nga viti paraardhës.

- Është realizuar gjithashtu zëri blerje pajisjesh për laboratorin e Informatikës në vlerën 8,297,400 lekë edhe kjo kontratë në vazhdim nga viti paraardhës.
- TVSH-ja për projekte të huaja është realizuar nga të ardhurat në vlerën 660,372 lekë Këto fonde janë rimbursuar me financimin nga Buxheti i Shtetit.

Për vitin 2020 Investimet e realizuara kanë qenë kontrata në vazhdim nga viti i mëparshëm. Investimet e parashikuara për vitin 2020 nuk janë realizuar për efekt pandemie dhe që ka shkaktuar edhe vonesë në vendmmarrjen e organeve kolegjale.

| Nr. | Emërtimi i projektit | Fondi lekë | |
|---|---|---|---|
| | | Plani | fakti |
| 1 | Pajisje elektronike dhe të laboratorit të fjalorit historik | 20,349,042 | - |
| 2 | Pajisje sportive Dep edukimit fizik dhe sporteve | 960,000 | - |
| 3 | Vegla muzikore | 960,000 | - |
| 4 | Kolaudim salla e konferencave FGJH | 34,500 | - |
| 5 | Likuidim TVSH Libra | 100,000 | 83,407 |
| 6 | Blerje pajisje projekti kërkimor "Vlerësimi i cilësise ekologjike të ujit të ekosistemit ujor të liqenit të Shkodrës sipas standarteve të BE dhe direktivës kuadër të ujrave" | 1,679,593 | - |
| | **Shuma** | **24,083,135** | **83,407** |

Investime te realizuara viti 2020 - të ardhurat e institucionit

| Nr. | Emërtimi i projektit | Fondi lekë |
|---|---|---|
| 2312103 | Rikonstruksion sala e konferencave FGJH | 7,812,328 |
| 2312112 | Likuidim TVSH Libra | 83,407 |
| 2314160 | Blerje pajisje laboratori I informatikes | 8,297,400 |
| 2318600 | TVSH blerje pajisje elektronike t@sk | 576,965 |
| | **Shuma** | **16,770,100** |

Përvec TVSH libra, nga tabela e realizimeve, të tjerat janë kontrata në vazhdim që nga viti paraardhës.

Strategjia afatmesme vazhdon e njëjtë si në Gusht 2021

➢ **Projektet e Huaja**

Projektet e huaja janë në vazhdim nga vitet e mëparshme si dhe ka aplikime nga departamentet për këto projekte si më poshtë:

| Projekte të huaja - UNISHK | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi i projektit | Viti i | | Statusi | Financimi lekë | | | | | | |
| | | | | | Të ardhura viti 2020 | | | Shpenzime viti 2020 | | | Gjendje në fund |
| | | Fillimit | Mbarimit | | Gjendja ne banke | Dizbursimi | Total | Korente | Kapitale | Libra | |
| 1 | Modernizing and harmonizing maritime education in Montenegro and Albania" | 2018 | 2021 | Në vazhdim | 2,122 | 821,881 | 824,003 | 2,422 | - | - | 821,581 |
| 2 | FINAC | 2016 | 2019 | Ka perfunduar nuk eshte mbyllur | 2,064 | 90,749 | 92,814 | 77,774 | - | - | 15,040 |
| 3 | Zhvillimi K M S ATP Shqip | 2017 | 2020 | Ka perfunduar nuk eshte mbyllur | 675,372 | - | 675,372 | 556,044 | - | - | 119,328 |
| 4 | Programi I bashkepunimit interreg-balkan-mediterrean 2014-2020* | 2017 | 2020 | Ka perfunduar nuk eshte mbyllur | - | 1,289,404 | 1,289,404 | 502,331 | - | - | 787,073 |
| 5 | "Drejt ndergjegjesimit, pergjegjesise dhe cilesise se perbashket ne punen sociale" projekti numer 585626-EP-1-IT-EPPKA2-CBHE-JP, Marreveshja numer 2017-2881/001-001 T@sk | 2017 | 2020 | Ka perfunduar nuk eshte mbyllur | 5,897,845 | - | 5,897,845 | 1,188,976 | 3,305,658 | 1,390,117 | 13,094 |
| 6 | "Operacion i BE-së mbi trajtimin e mangësive gjatë bashkëpunimit ndërkufitar të ofruesve në trajnim-Safe Harbor" | 2018 | 2020 | Ka perfunduar nuk eshte mbyllur | 1,229,379 | - | 1,229,379 | 1,229,379 | - | - | - |
| 7 | Reformimi I studimeve në Mal te Zi dhe Shqiperi | 2018 | 2021 | Në vazhdim | 5,255,526 | - | 5,255,526 | 1,183,132 | 3,501,087 | - | 571,308 |
| 8 | Shkëmbimi virtual i Universiteteve Shqiptare-Evropiane-VALEU-X | 2020 | 2022 | Në vazhdim | - | 1,563,890 | 1,563,890 | 816,170 | - | - | 747,720 |
| | Shuma | | | | 13,062,310 | 3,765,925 | 16,828,234 | 5,556,229 | 6,806,745 | 1,390,117 | 3,075,144 |

Universiteti për vitin 2020 ka 8 projekte të huaja me gjendje monetare në bankë ose pritet të financohen. Nga projektet e huaja në bankën e nivelit të dytë janë gjendje 3,075,144 lekë.
Nga procedurave të zbatimit të buxhetit TVSH-ja përballohet nga Buxheti i Shtetit. Për të zbatuar afatet e përcaktuara në likuidimin e faturave ndaj të tretëve, TVSH-ja është planifikuar të përballohet nga të ardhurat e institucionit dhe do të kërkohet rimbursimi i saj nga Buxheti i Shtetit.

## 2. Realizimi i buxhetit Janar–Shtator 2021

Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **901,725,670** lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

| | Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për 9 mujorin viti 2021 | | | lekë |
|---|---|---|---|---|
| Nr | Emërtimi i projektit | Mbartur nga viti 2020 | Financimi viti 2021 | Buxheti 9 mujori viti 2021 |
| 1 | Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta) | *175,273,179* | *526,916,913* | *702,190,092* |
| 2 | Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar | *80,210,316* | *119,325,262* | *199,535,578* |
| | **TOTALI** | ***255,483,495*** | ***646,242,175*** | ***901,725,670*** |

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta) Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) **702,190,092** lekë
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) **199,535,578** lekë,

## 2.1. Hyrjet e fondeve për 9 mujorin e vitit 2021

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2021 (9 mujori) buxheti i akorduar dhe i çelur është në vlerën **928,312,587** lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

| *Nr* | **Fonde të hyra "Buxheti 9 mujori viti 2021"** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Emërtimi i programit** | **Buxheti vjetor** | ***Akorduar*** | ***në %*** |
| I | Grant mësimdhënie e bursat e studentëve | 702,190,092 | *702,190,092* | *100.00* |
| **II** | **Grant** | **702,190,092** | ***702,190,092*** | **100.00** |
| 1 | Të ardhurat e trashëguara viti 2020 | 80,210,316 | *80,210,316* | 100.00 |
| 2 | Të ardhura jashtë limiti viti 2021 | 103,301,700 | *111,517,261* | 107.95 |
| **III** | **Të ardhura** | **183,512,016** | ***191,727,577*** | **104.48** |
| 1 | Projekti të huaja | 34,394,918 | *34,394,918* | 100.00 |
| **IV** | **Projekti të huaja** | **34,394,918** | ***34,394,918*** | **100.00** |
| | **Totali** | **920,097,026** | ***928,312,587*** | **100.89** |

- Projekte të huaja **34,394,918** lekë, ose 3.7 %
- Grant për mësimdhënie e bursat e studentëve në vlerën **702,190,092** lekë, ose 75.6 %
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) në vlerën **191,727,577** lekë, ose 20.7 %

| Të Ardhurat për 9 mujorin viti 2021 - fakti | | |
|---|---|---|
| *Nr* | Emërtimi | *Fakt* |
| *1* | *Qira* | 162,775 |
| 2 | *Tarifa shkollimi* | 94,154,228 |
| 3 | *Taksë regjstrimi* | 1,341,900 |
| 4 | *Tarifa konkurimi* | 180,000 |
| 5 | *Shërbime te ndryshme* | 14,536,858 |
| 6 | *Analiza laboratorike* | 1,141,500 |
| **B** | **Të ardhurat e vitit 2021** | **111,517,261** |
| 1 | Trashëguar nga viti 2020 | 80,210,316 |
| **Totali** | | **191,727,577** |

Në zërat e të ardhurave për t'u grumbulluar gjatë periudhës janar – shtator 2021, grumbullimi i të cilave është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria Ekonomike dhe fakultetet, peshën kryesore e zënë:

- Qira 0.1%,
- Tarifat e shkollimit 84.4 % ,
- Taksë regjistrimi 1.2 %,
- Tarifa konkurrimi 0.2%,
- Shërbime të ndryshme 13%
- Analiza laboratorike 1 % ,

Në realizimin e të ardhurave kanë ndikuar edhe efekte në ulje:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe reduktimi i tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM – së dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës së plotë të tarifës së shkollimit. Për detaje tabela në fund të paragrafit.
- Ka rënie të regjistrimeve në disa programe studimi.
- Të ardhurat janë çelur për përdorim sipas ndarjeve në Buxhetin e vitit 2021 për Universitetin, mbështetur në domosdoshmërinë për shpenzim për çdo artikull dhe kontratave të lidhura e të realizuara në investime e shpenzime operative, si dhe për shpenzime të tjera korrente.

| NR | Efektet e Vendimeve të Keshillit te Ministrave "Per studente tqe perfitojne bursa financiare , përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2020-2021, sipas VKM si me poshte | Total Nr studente | Total efekti financiar ( viti akademik 2020-2021) | Numri I studenteve me noten mesatare 9-10, qe perfitojne bursa financiare+perjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit. Viti akademik 2020-2021 | Efekti financiar per studentet me note mesatare 9-10,bursa+ tarifa vjetore e shkollimit. | Numri I studenteve nga kategorite sociale ne nevoje qe perfitojne bursa+ tarifa vjetore e shkollimit. | Efekti financiar ga kategorite sociale ne nevoje qe perfitojne bursa+ tarifa vjetore e shkollimit. (Viti akademik 2020-2021) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | A=C+E | B=D+F | C | D | E | F |
| a 1 bursat | Studente qe perfitojne bursa financiare sipas VKM nr. 903, date 21.12.2016, i ndryshuar me VKM nr. 39, date 23.1.2019. **Me Vendim BA** | 640 | **57,600,000** | 190 | 17,100,000 | 450 | 40,500,000 |
| a 2 bursat | Studente qe perfitojne bursa financiare sipas VKM nr. 903, date 21.12.2016, i ndryshuar me VKM nr. 39, date 23.1.2019 , **që kanë paraqitur kërkesë në plotësim të kritereve, në pritje të konfirmimeve nga institucionet përkatëse për të përfituar bursë financiare** | 2 | **180,000** | 0 | 0 | 2 | 180,000 |
| | ***Total Bursat 2020-2021 a1+a2*** | ***642*** | ***57,780,000*** | ***190*** | ***17,100,000*** | ***452*** | ***40,680,000*** |
| b.1 tarifat | Numri i studenteve qe perfitojne nga ulja/reduktimi me 50% i tarifes vjetore te shkollimit per vitin akademik 2020-2021 sipas VKM nr. 288 date 21.05.2018, i ndryshuar (Cikli i pare i studimeve)_viti i parë, i regjistruar 2020 | **848** | **9,390,000** | 848 | 9,390,000 | 0 | 0 |
